



## Komuna e Prishtinës

### RAPORT PUNE

Drejtoria	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm
Periudha raportuese	Maj 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

### PËRMBLEDHJE

*Të shkruhet shkurtimisht një përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues).*

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm gjatë këtij muaji ka vazhduar t'i kryejë punët dhe detyrat sipas planit të paraparë:

### AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

#### **Spektori i planifikimit strategjik:**

- Trajnim për Q-GIS;
- Analiza dhe propozimet për lokacionin e Spitalit të qytetit;
- Analiza për procedurën e hartimit të PZHK-së dhe HZK-së;
- Mbatjtja e takimit me SUMP, lidhur me përgjigjet në komentet e bëra më parë;
- Vlerësimi teknik për Sallën koncertale, mbledhja e materialit;
- Kontrollimi i planeve të unifikuara në CAD Sisteme me ato të aprovuara nga KK për Plani zhvillimor komunal, Plani zhvillimor urban;
- Takime me palë gjatë ditëve të marta dhe të enjte nga ora 09:00 deri në orën 12:00.

#### **Spektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Ngarkesa e bizneseve me taksë komunale, në bazë të Rregullores për ngarkesa dhe gjoba komunale;
- Dhënia e vërtetimeve për biznese që nuk kanë obligime;
- Dhënia e lejeve për biznese dhe transport;

- Vazhdimi i lejeve të punës për “Auto-Taxi”.

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efiçiente**

- Manifestimi për nder të Ditës Botërore të Mjedisit dhe Sportit, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës.

### **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA**

*Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga sektori juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Gjatë këtij muaji janë realizuar këto punë:

### **Sektori i planifikimit strategjik**

- Dhënia e komenteve lidhur me projektin për banim me kosto të përballueshme, takim bashkë me përfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit;
- Punëtori me zyrtarët komunalë lidhur me realizimin dhe shtrirjen, si dhe koston e shpronësimit për rrugën “A”, që lidh lagjet “Kalabria”, “Prishtina e Re”, “Mati” dhe “Zllatari”;
- Analiza e shtrirjes së kolektorit në lagjen “Kalabria” lidhur me pronësinë dhe mënyrën e shpronësimit. Takimi u mbajt me pronarët, drejtorët dhe zyrtarët nga Drejtoria e Pronës dhe Investimeve Kapitale;
- Takim me IRUSP/NIRAS lidhur me kontrollimin e planeve rregulluese”;
- Konsultime me zyrtarë nga Drejtoria e Urbanizmit, lidhur me PRRH për tërësinë urbane “b”, të lagjes “Prishtina e Re - Zona Lindje”, Prishtinë 2017-2025;
- Përmbledhja dhe analiza e materialit për kufirin e parkut “Gërmia” - Peizazh i mbrojtur;
- Përzgjedhja e ngjyrës së pllakave për sheshin “Adem Jashari”;
- Është kompletuar prezantimi për objektin e garazhit nëntokësore, projekti me PPP;
- Përpilimi i projektraportit dhe përcjellja e tij grupit punues, lidhur me realizimin dhe shtrirjen, si dhe koston e shpronësimit për rrugën “A” që lidhë lagjen “Kalabria”, “Prishtinën e Re”, “Mati” dhe “Zllatari”;
- Analiza e shtrirjes së kolektorit në lagjen “Kalabria”, lidhur me pronësinë dhe mënyrën e shpronësimit, mbajtja e takimit të dytë me pronarët, drejtorët dhe zyrtarët nga Drejtoria e Pronës dhe Investimeve Kapitale;
- Mbajtja e trajnimit për grupin e parë të sektorit të Planifikimit, lidhur me kontratën për modernizimin e dokumenteve të planifikimit lidhur me kontrollimin e planeve rregulluese”;

- Hartimi i arsytimit për Kuvend lidhur me vendimin për vendosjen e memorialit për ushtaret e KFOR-it francez;
- Mbajtja e takimit në MMPH lidhur me caktimin e kushteve ndërtimore për KOSTT;
- Pjesëmarrja në Punëtorinë lidhur me Zonën e Kampusit Universitar, organizuar nga OJQ "Ec ma ndryshe".
- Mbajtja e punëtorisë 3-ditore ( e premte, e shtunë dhe e diele), MINECRAFT lidhur me projektin e Parkut të Qytetit;
- Vlerësimi teknik për Sallën koncertale, mbajtja e takimit të parë informues për procesin;
- Konsultime me Sektorin e mjedisit, lidhur me përqindjen e gjelbërimit në kuadër të planeve rregullues urbane;
- Konsultime me përfaqësues nga Plani i Mobiliteti SUMP lidhur me VSM-në dhe pikat e tjera të këtij plani;
- Konsultime me përfaqësues nga Drejtoria e Pronës, lidhur me përcaktimin e lokacioneve të ndërmarrjeve "Trafiku Urban", "Hortikultura" dhe "Pastrimi";
- Takimi i dytë me drejtorët e ndërmarrjeve "Trafikut Urban" dhe "Hortikultura" lidhur me definimin e kufijve të këtyre ndërmarrjeve publike;
- Takim me përfaqësuesit nga Drejtoria e Pronës dhe pronarin lidhur me këmbimin e tokës për ndërtimin e shkollës së planifikuar në lagjen "Prishtina e Re - Zona Perëndim";
- Takimi me përfaqësues nga "World Bank Group Office" në Kosovë lidhur me lokacionet e propozuara për katër shkollat.
- Punëtorja e dytë me TAT, me përfaqësues nga grupi për vlerësimi teknik të Sallës koncertale;
- Analiza dhe hartimi i raportit për rrugën e planifikuar "A", që lidh lagjet "Zllatari", "Mati", "Prishtinën e Re dhe "Kalabria";
- Shkëmbimi i informatave lidhur me projektin me kosto të përballueshme;
- Shkëmbimi i informatave lidhur me lokacionet për vlerësimin teknik të Sallës koncertale me grupin TAT ;
- Mbajtja e takimit me përfaqësues nga Rektorati i Universitetit " Hasan Prishtina";
- Konsulta lidhur me detyrën projektuese për projektin e QMF-së në Veternik;
- Kontrollimi i materialit të dorëzuar për PRRH "Kodra e Trimave 1 " dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të Komunës;
- Konsultime me Drejtorinë e Investimeve Kapitale lidhur me rrjetin rrugor për lagjen "Hajvalia";
- Analiza e lokacionit për çerdhen "Gëzimi ynë";

- Takim me zyrtarët nga Drejtoria e Urbanizmit lidhur me shtjellimin e disa lëndëve;
- Pjesë e komisionit për vlerësimin e tenderit “Pastrimi i objekteve të trashëgimisë në objektet e ish-Konsullatës dhe objektet përcjellëse”;
- Takim me zyrtarë nga Zyra për regjenerim urban dhe drejtorët nga Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Arsimit lidhur me projektin për identifikimin e pronave ku shtrihen infrastruktura publike dhe sociale;
- Printimi dhe harmonizimi i hartave për nevoja të Policisë së Kosovës;
- Takim me përfaqësues nga SUMP lidhur me Planin e mobilitetit”;
- Analiza të ndryshme lidhur me projektin e katër shkollave të planifikuara në lagjet “Arbëria 3”, “Mati 1”, “Sofalia” dhe “Prishtina e Re -Zona Perëndim”;
- Takim me zyrtarë nga Drejtoria e Shëndetësisë lidhur me parcelën për QMF në kuadër të Planit rregullues urban “Prishtina e Re - Zona Perëndim”;
- Analiza e lokacioneve për Sallën koncertale;
- Takim me UN “Habitat” lidhur me projektin në parkun e qyteti “Bllok pas blloku”.

### **Spektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Janë dhënë 178 vërtetime për persona fizikë që nuk ushtrojnë aktivitet biznesi;
- Janë dhënë 1 vërtetim për biznese që nuk ngarkohen me taksë komunale;
- Janë bërë 5 kontrole, 6 të bizneseve për pagesë të taksës komunale;
- Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste - 7;
- Kërkesë për ndërrim të automjetit dhe vazhdim të lejeve për “Auto-Taksi” - 14;
- Kërkesë për leje “Auto-Taxi” - 1;
- Leje në procedurë - 6.

### **Spektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë**

- Manifestimi i Ditës Botërore të Mjedisit dhe Sportit;
- Takimi me përfaqësuesit e Komitetit Olimpik për mbajtjen e aktiviteteve të përbashkëta për shënimin e Ditës Botërore të Mjedisit dhe Sportit;
- Takimi me Luan Hasanaj nga OJQ “Let’s do it Kosova” për pastrimin e një deponie me mbeturina në Bardhosh;
- Mbjellja e 105 drurëve në Kompleksin e varrezave të dëshmorëve në lagjen “Velania” nga të rinjtë e shteteve të ndryshme të botës, në bashkëpunim me të rinjtë vendorë;
- Takimi me znj. Genta Deva nga kompania “Pro eca” në kuadër të projektit “Up with people” i cili u mbajt në Prishtinë;
- Përgatitja e detyrës projektuese për dizajnimin e fletushkave “Vlerat natyrore të biodiversitetit”:

- Takimi me përfaqësuesen e Bankës Botërorë, znj. Ivana Boic, për dhurimin e 20 drurëve si donacion.

### **Zyra për rigjenerim urban:**

- Projekti i parkut në lagjen "Kodra e Trimave";
- Projektimi i shtigjeve për këmbësore në lagjen "Dardania";
- Projektimi i fushë-lojës në rrugën "Afrim Loxha", te blloku i vjetër;
- Takim me zyrtarët e DKA -së dhe zyrtarët e kompanisë projektuese të çerdhes "Yllkat".

## **AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

### **Sektori i planifikimit strategjik**

- Plani i mobilitetit (SUMP), në procedurë.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm:**

- Vazhdimi i lejeve të punës për biznese.

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efiçente**

- Aktivitetet mjedisore, 5 qershor, Dita Botërore e Mjedisit;
- 22 Shtator Dita e Qyteteve pa Makina;
- Tenderimi i broshurave me vlera natyrore.

### **Zyra për rigjenerim urban**

- Dizajnimi i shtandëve mobile;
- Dizajnimi i shportave;
- Mobiliari urban
- Qoshqet;
- Projekti i renovimit të katit përdhes të objektit të vjetër të Komunës.

## **STATISTIKAT**

*Shënimi, ku është e nevojshme shpjegoni, të gjitha statistikat përkatëse për sektorin tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje*

*në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas detyrave të sektorit tuaj.*

## **BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE AI I SHPENZUAR PËR PËRIUDHEN RAPORTUESE**

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Janë planifikuar për këtë periudhë 8.500,00 €;
- Janë realizuar 6.800,00 €.

## **TAKIMET ME PALË**

### **Sektori i planifikimit strategjik**

- Kanë vazhduar takime të shumta në ditët e parapara për takime me palë.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Janë realizuar disa takime me palë-grupe të interesit, kryesisht nga komuniteti i biznesit.

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efiçente**

- Kanë vazhduar takime të shumta në ditët e caktuara për takime me palë.

### **Zyra për rigjenerim urban**

- Takim me qytetarë të lagjes “Dardania”. Diskutim rreth projektit të Santea;
- Takim me zyrtarët e DKA-së dhe kompaninë projektuese të çerdhes “Yllkat”.

## **TAKIMET ME INSTITUCIONET TJERA**

### **Sektori i planifikimit strategjik:**

- Gjithashtu, janë organizuar edhe takime të ndryshme me institucionet.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Koordinimi i aktiviteteve me MTI in dhe Komunat e rajonit të Prishtinës, për ngritjen e nivelit të aplikimit për kategorizimin e objekteve akomoduese, si dhe sensibilizimin e operatorëve të këtij lëmi për kategorizim.

- **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efiçiente**  
Gjithashtu, janë organizuar edhe takime të ndryshme me institucione.

## DISKUTIME PUBLIKE/TAKIMET ME QYTETARË

### Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

#### Sektori i planifikimit strategjik

nr.	Përshkrimi i lëndës	Numri i lëndëve të trajtuara
1	Aktpërcjellës	1
2	Kërkesa për nivelin lokal dhe qendror	
3	Informime nga Plani (PZHU, PRRU)	34
4	Caktim i vijës rregulluese	
5	Komisione	1
6	Leje mjedisore komunale	
7	Shqyrtime publike	
8	Pëlqime për bashkim të parcelave	2
9	Parcelime- informime	6
10	Pëlqime të ndryshme (mjedisor/renovim/rrethojë)	
11	Kontrollim të projekteve	
12	Plotësime dokumentacioni	
13	Refuzime	
14	Mbikëqyrje të projekteve	
15	Tërheqja e lëndës nga pala	
16	Arsyetime për Kuvend komunal dhe kërkesa të tjera	
17	Detyra projektuese	
18	Mbikëqyrje të planeve rregulluese	
19	Mbikëqyrje të projekteve (p.sh. incizime gjeodezike )	
20	Të ndryshme	1
21	Kërkesat online	43
22	Gjithsej numri i lëndëve të pranuar në këtë periudhë	48+ 43
23	Gjithsej numri i lëndëve të trajtuara në këtë periudhë	88
24	Numri i lëndëve në trajtim e sipër	3

#### Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm

- Janë pranuar gjithsej 194 kërkesa dhe të gjitha janë të kryera.

- **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efeçiente**

nr.	Përshkrimi i lëndës	Numri i lëndëve të trajtuara
1	Aktpërcjellës	1
2	Kërkesa për nivelin lokal dhe qendror	
3	Informime nga Plani (PZHU, PRRU)	
4	Caktim i vijës rregulluese	
5	Komisione	
6	Leje mjedisore komunale	6
7	Aktvendime për kompensim	8
8	Pëlqime për bashkim të parcelave	
9	Parcelime- informime	
10	Pëlqime të ndryshme (mjedisor/renovim/rrethojë)	1
11	Kontrollim të projekteve	
12	Plotësime dokumentacioni	
13	Refuzime	
14	Mbikëqyrje të projekteve	
15	Tërheqja e lëndës nga pala	
16	Arsyetime për Kuvend komunal dhe kërkesa tjera	
17	Detyra projektuese	
18	Mbikëqyrje të planeve rregulluese	
19	Mbikëqyrje të projekteve ( psh. Incizime gjeodezike )	
20	Lëndë të shqyrtuara nga Komisioni për LMK	4
21	Gjithsej numri i lëndëve të pranuar në këtë periudhë	15
22	Gjithsej numri i lëndëve të trajtuara në këtë periudhë	
23	Numri i lëndëve në trajtim e sipër	20

### SFIDAT

*Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda sektorit, drejtorisë, komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

### **Sektori i planifikimit strategjik**



- Mungesa e stafit me profil adekuat.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Duhet të ndërhyhet në programin ekzistues, gjegjësisht të freskohen të dhënat për biznese;
- Meqenëse regjistrimi i bizneseve nuk është delegua nga ARBK-ja në Komunën e Prishtinës, dhënia e vërtetimit që personat fizikë nuk ushtrojnë aktivitet biznesi të kaloj në ARBK.

## **REKOMANDIME**

*Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.*

### **Sektori i planifikimit strategjik**

Rekomandoj që gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit të hartohet strategjia e shpronësimit, të definohet saktë, qoftë me rregullore ose vendim.

Incizimi satelitor ( ortofoto 2018) për komunën e Prishtinës, me ç ‘rast do të kemi pasqyrën e qartë dhe gjendjen faktike të ndërtuar në Komunën e Prishtinës.

Rekomandoj që për vitin 2018, arkiva dixhitale e planifikimit, gjegjësisht planet hapësinore të mbrohen në atë mënyrë që mos të jenë të edituara nga secili zyrtar, në kuadër të kësaj të pajisemi edhe me licenca të Auto-Deskut.

Rekomandoj po ashtu që për vitin 2018 të kemi vizita profesionale jashtë vendit, apo trajnime të ndryshme profesionale, përmes të cilave do të kemi mundësi të bëjmë shkëmbim të përvojave nga lëmi i planifikimit.

- Të rritet numri i profesionistëve brenda Drejtorisë;
- Të bëhen disa trajnime të duhura;
- Të mund të bëhen hulumtime më shumë rreth zgjidhjeve urbane.

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efecientë**

Rekomandoj po ashtu që për vitin 2018, të kemi vizita profesionale jashtë vendit, apo trajnime të ndryshme profesionale, përmes të cilave do të kemi mundësi të bëjmë shkëmbim të përvojave nga lëmi e mjedisit.

- Trajnime të duhura për mbrojtjen e mjedisit.

## **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES**

*Listoni aktivitetet e planifikuara për sektorin tuaj për muajin pasues*

### **Sektori i planifikimit strategjik**

- Fillimi i hartimit të Plani zhvillimor komunal, përgatitjet.
- Fillimi i hartimit të Hartës zonale komunale, përgatitjet.

### **Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm**

- Vlerësimi i aplikacioneve dhe verifikimi i plotësimit të kritereve të përcaktuara nga organi përkatës komunal;
- Shqyrtimi i lëndëve të pranuar në terren;
- Pagesa e taksave komunale për biznese;
- Dhënia e lejeve për biznese.

### **Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë eficientë**

- Aktivitete të shumta me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Mjedisit dhe Sportit në bashkëpunim me komitetin olimpik;
- Vazhdimi i pjesës së dytë të projektit “Inventarizimi i ndotësve të ajrit”.

### **Zyra për rigjenerim urban**

- Dizajnimi i klasës model.